

Procesverbal i Kuvendit të Punës së FBK-së

Më 22 mars 2023, Prishtinë

Rendi i Ditës

1. Zgjedhja e trupave punues
 - Kryesia e punës
 - Komisioni verifikues
 - Procesmbajtësi
2. Miratimi i procesverbalit të Kuvendit të Punës 01.10.2022
3. Draft-Raporti i Punës së FBK-së për vitin 2022
4. Draft-Raporti i Auditimit për vitin 2022
5. Draft-Plani i Veprimit për vitin 2023
6. Draft-Plani Financiar për vitin 2023
7. Draft-Plani i Marketingut për vitin 2023
8. Të ndryshme

Hyrje

Kuvendi i Punës së Federatës së Basketballit të Kosovës (FBK) u mbajt më 22 mars 2023 në hotelin "Four Points by Sheraton Prishtina". Kuvendi filloi në ora 17:30 dhe u kryesua nga Kryetari i FBK-së, z. Arben Fetahu në prani të Sekretares së Përgjithshme të FBK-së, z-njës Elvira Dushku. U sigurua që kishte kuorum të mjaftueshëm për të mbajtur Kuvendin e Punës meqenëse të pranishëm ishin 31 nga 40 delegatë sa ka gjithsej Kuvendi i FBK-së.

Të pranishmit miratuan rendin e ditës të Kuvendit të Punës pa asnjë vërejtje.

U formuan Kryesia e punës, Komisioni Verifikues dhe u caktua Procesmbajtësi.

Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës të FBK-së, z. Shaqir Totaj, tregoi për takimin e mbajtur me Sekretaren e Përgjithshme dhe frymën e mirë të punës që po mbizotëron në Federatë. Ai theksoi se në bazë të gjetjeve, puna që po bëhet në Federatë është për çdo lëvdatë dhe nuk ka asgjë të jashtëzakonshme për të raportuar.

Miratimi i procesverbalit për vitin 2022

Delegatët miratuan procesverbalin e punës pa asnjë vërejtje.

Më pas Kryetari i FBK-së, z. Arben Fetahu, nisi takimin duke folur shkurtimisht për planin strategjik të FBK-së 2021-2025, i cili monitorohet në baza tremujore. Sipas z. Fetahu, plani strategjik është duke zbatuar sipas afateve kohore, megjithatë ai tha se duhet të konsolidohemi më mirë si komunitet i basketbollit.

Më tej, ai foli se Federata është duke punuar me sponsorët, gjë që vërehet edhe përmes rritjes së numrit të tyre, rrjedhimisht edhe rritjes së buxhetit të FBK-së.

Kryetari Fetahu raportoi edhe për vendimin për pezullimin e aktiviteteve të Ligës Unike tek meshkujt, duke theksuar se ky vendim ka qenë shumë i dhimbshëm, por jo gjithçka është varur nga FBK dhe klubet tona, të cilat kanë dëshmuar gatishmëri maksimale, përderisa në anën tjetër ekipet e meshkujve nga Shqipëria nuk e kanë pasur të njëjtin vullnet dhe frymë pozitive për të filluar edicioni i ri në këtë ligë. Në anën tjetër ai ka shtuar se Liga Unike e Femrave ka vazhduar dhe se është kurorëzuar një javë më parë me Final Four të organizuar në vlorë ku fituese doli ekipi nga Tirana, Partizani.

Raporti i Punës së FBK-së për vitin 2022

Meqë shumë tema që kanë të bëjnë me Raportin e Punës për vitin 2022 ndërlidheshin edhe me implementimin e planit strategjik të FBK-së 2021-2025, kryetari i FBK-së Fetahu foli për rezultatet e dobëta që përfaqësueset e Kosovës i kanë pasur në garat ndërkombëtare, si dhe përmendi organizimet për vitin 2023. Sipas Fetahut, aktivitet shumë i qëlluar është organizimi i Junior NBA, që ditë më parë e ka filluar edicionin e dytë me tërheqjen e shortit të organizuar nga FBK dhe Jr NBA.

Lidhur me programin e FIBA Europe Youth Development Fund, kryetari Fetahu përmendi se efektet afatgjata të këtij aktiviteti do të shihen në vitet e ardhshme, por mbetet sfida puna me gjeneratat e reja.

Më tej u nënvizua se Liga Ballkanike nuk po tregon rezultatet e dëshirueshme. Megjithatë, kryetari Fetahu vuri në pah se FIBA ka dërguar një letër publike falënderimi KB Trepçës për organizimin e shkëlqyeshëm të grupit të organizuar në kuadër të FIBA Euro Cup në Mitrovicë.

Në vijim të raportimit, kryetari Fetahu përmendi organizimin e FIBA 3x3 Challenger Prishtina, i cili sipas raportimeve ishte aktivitet shumë i mirë.

Federata e Basketbollit e Kosovës do të organizoj ngjarje të mëdha këtë vit: FIBA U16 Kampionatin Evropian, Divizioni C, FIBA 3x3 U23 Nations League, si dhe do ti asistoj klubit 3x3 Prishtina në organizimin e FIBA 3x3 Challenger Prishtina.

Kryetari Fetahu gjithashtu raportoi edhe për vizitën e Sekretarit të Përgjithshëm të FIBA World, z. Andreas Zagklis, i cili inkurajoi FBK-në që të vazhdojë investimet në 5x5, por vëmendje të veçantë t'i kushtohet 3x3, sepse edhe kjo e fundit është disiplinë olimpike.

Ndër të tjera u përmendën edhe seminarët e organizuara nga FBK dhe FIBA për fuqizimin e klubeve tona, nga të cilat kanë përfituar një numër i konsiderueshëm i pjesëtarëve të komunitetit të basketbollit.

Si sfidë u përmend shkuarja e disa prej gjyqtarëve më cilësorë dhe mos-plotësimi i dokumentacionit të nevojshëm për licencim të klubeve nga MKRS-ja. Afati i fundit për licencim është 31 mars 2023 dhe sipas kryetarit Fetahu, FBK-ja do të detyrohet t'i pezullojë të gjitha klubet që nuk i përmbushin kriteret. Ai sërish tha se FBK-ja është në dispozicion të të gjitha klubeve dhe ju ofron ndihmë sa herë që është e nevojshme.

Ndër sfidat kryesore mbesin:

- Konsolidimi i klubeve të femrave;
- Takimet me sponsorët dhe kryetarët e komunave në lidhje me ndihmën që mund të ofrojnë ata për basketboll;
- Nisja e aktivitetit 3x3 si pilot-projekt për garat shkollore;

Draft-raporti i Punës së FBK-së për vitin 2021 u miratua pa asnjë vërejtje.

Draft-raporti i Auditimit të FBK-së për vitin 2022

Draft-raportin e auditimit të FBK-së për vitin 2022 e paraqiti kryetari Fetahu. Auditori nuk ka gjetur ndonjë vërejtje substanciale përveç disa çështjeve teknike në lidhje me çështjen e pagesave për gjyqtarët dhe se vërejtjet e z. Fatmir Gashi për çështjet financiare në vitin 2022 janë marrë parasysh dhe janë përfshirë në draft-raportin e auditimit.

Buxheti për vitin 2022 ishte 1.28 milion euro, gjersa buxheti i shpenzuar është 1.37 milion euro.

Fetahu tha se krahasuar me vitin 2018, në vitin 2022 buxheti i FBK-së është dyfishuar dhe buxheti për vitin 2023 është 2.2 milion euro, të cilat përfshijnë edhe grantet nga organizatat e ndryshme të huaja, si projektet e Erasmus, Ambasada Amerikane, sponsorët e përgjithshëm të FBK-së dhe më e rëndësishmja, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Raportin i auditimit është i qasshëm edhe në uebfaqen e FBK-së.

Raporti i auditimit për vitin 2022 u miratua pa vërejtje tjera.

Draft-Plani i Veprimit 2023

Draft-Plani Financiar 2023

Draft-Plani i Marketingut 2023

Këto tri pika të rendit të ditës Kryetari Fetahu i prezantoi njëkohësisht dhe u miratuan pa asnjë vërejtje.

Të ndryshme

Kryetari Fetahu prezantoi një ide që do të mund të ishte e suksesshme: hapja e degëve të Qendrës Nacionale të Basketbollit në qytetet kryesore për të ngritur cilësinë e lojtarëve vendorë, sepse sipas tij dhe anëtarit Fatmir Gashi, puna me gjeneratat e reja mbetet përgjegjësi kolektive.

Me kërkesë të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës të FBK-së, Artan Spahija, i cili për arsye personale nuk mund të jetë më në Këshill, u bë zëvendësimi i tij me Dren Zatriqin. Kjo kërkesë u miratua nga të pranishmit pa vërejtje.

Përmbyllja e Kuvendit të Punës

Kuvendi i punës i mbylli punimet në orën 18:55. Kryetari Fetahu i falënderoi të gjithë delegatët për pjesëmarrje dhe i ftoi për një koktej rasti.

Përgatiti:

Vlora BRAHA

Procesmbajtëse

Miratoi:

Arben FETAHU

Kryetar

Federata e Basketbollit e Kosovës, Kuvendi i Punës 22.03.2023, Prishtinë